

THE STATE EDUCATION DEPARTMENT /
THE UNIVERSITY OF THE STATE OF NEW YORK / ALBANY, NY 12234
Office of Bilingual Education and World Languages

55 Hanson Place, Room 594
Brooklyn, New York 11217
Tel: 718-722-2445 Fax: 718-722-2459

89 Washington Avenue, Room 528EB
Albany, New York 12234
Tel: 518-474-8775 Fax: 518-474-7948

KARTA E TË DREJTAVE TË PRINDËRVE PËR NXËNËSIT E GJUHËS ANGLEZE TË SHTETIT TË NJU -JORKUT

"Commissioner Regulations Part 154" e Departamentit të Arsimit të Shtetit të Nju-Jorkut (The New York State Education Department, NYSED) ju jep juve - prindërve/kujdestarëve të nxënësve të gjuhës angleze (English Language Learners, ELLs):

1. Të drejtën që fëmijët tuaj të marrin arsim publik falas në rajonin shkollor ku banoni, pavarësisht nga statusi i imigrimit tuaj apo i fëmijës suaj (p.sh. pavarësisht nëse anëtarët e familjes tuaj janë nënshetas, imigrantë ose pa dokumente) dhe pavarësisht nga gjuha që flisni ju dhe fëmijët tuaj.
2. Të drejtën t'i regjistroni fëmijët tuaj në shkollë pa ju kërkuar që të jepni informacion ose dokumente që mund të tregojnë statusin e imigrimit tuaj ose të fëmijëve tuaj. Nuk mund t'ju kërkohej që të jepni kartën ose numrin e sigurimeve shoqërore (social security card), vizën e imigrimit ose statusin e vizës, ose dokumentet e nënshetësisë apo statusin e nënshetësisë.
3. Të drejtën, sipas ligjit federal, për të pasur një përkthyes të kualifikuar në gjuhën tuaj të preferuar për komunikime kritike me rajonin e shkollës.
4. Të drejtën që fëmijët tuaj të futen në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education, BE) kur ka 20 a më shumë nxënës të klasës që flasin të njëjtën gjuhë kryesore/të shtëpisë. [1]
5. Të drejtën për njoftim me shkrim në anglisht dhe në gjuhën tuaj të preferuar se fëmijët tuaj janë identifikuar si nxënës të gjuhës angleze (ELL) dhe se do të futen në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) ose të anglishtes si gjuhë e re (English as a New Language) (të quajtur më parë "anglishtja si gjuhë e dytë"). [2]
6. Të drejtën për një sesion orientimi me cilësi të lartë, të ofruar nga rajoni juaj shkollor, i cili përqendrohet në standardet shtetërore, provimet dhe çka pret shkolla nga nxënësit e gjuhës angleze (ELL), si dhe synimet e programit, dhe kriteret për arsimin dygjuhësor (Bilingual Education) dhe anglishten si gjuhë e re (English as a New Language). Ky orientim duhet të bëhet para vendosjes përf -4.d1n nglish as duhet të bëhet në gjuhën tuaj të preferuar.
7. Të drejtën për të marrë informacion për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve tuaj në anglisht, si edhe për zhvillimin gjuhësor të tyre në gjuhën që flasin në shtëpi, në qoftë se janë në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education).
8. Të drejtën për t'u takuar me stafin e shkollës të paktën një herë në vit, përveç takimeve të tjera që kërkohen në përgjithësi, për të diskutuar përparimin e përgjithshëm të fëmijëve tuaj në mësim dhe zhvillimin e tyre gjuhësor.
9. Të drejtën që fëmijët tuaj të futen në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) ose të

